

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**DHOMA E NOTERISE TIRANE**  
**NR. 6188 REP.**  
**NR. 382 KOL**

**KONTRATE DHURIMI**

Në Tiranë sot më datën 20.11.1998 u paraqitën para meje noteres publike Miranda Xhemalçe personalisht palët si më poshtë:

**DHURUSI:** Ndrëçim Shehaj i biri i Qamilit , i datlindjes 1947. lindur në Gjirokastër dhe banues në Tiranë , Rr. Shemsi Haka, Nr.58/1 ,madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, themelues dhe ortak i vetëm i shoqërisë "ILIRIA" '98 sh.p.k. , i njohur si i tillë me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nr19019, dt.12.3.1998 , i cili deklaroi me vullnet të plotë e të lirë se shoqërinë "ILIRIA" '98sh.p.k., themelues pronar dhe ortak i vetëm i të cilës është ja dhuron pa kurrëfar kushtesh as barre Z, Shefqet Dizdari.

Dhurusi këtë shoqëri e ka themeluar si ortak i vetëm me aktin e themelimit Dt.18.2.1998dhe ka bërë njohjen e saj në Gjykatë me Vendimin 19019, dt..12.3.1998.Që nga njohja e shoqërisë "ILIRIA" '98 nga Gjykata është bërë rregjistrimi i saj në zyrën e tatimeve të rrethit Tiranë dhe shoqëria funksionon normalisht, aktualisht si Zyrë e Këmbimit Valutor, në një nga ambjentet e marra me qira nga drejtorja e Teatrit të Kukullave Tiranë.

Dhurusi deklaroi njëkohësisht se shoqëria "ILIRIA" '98 sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet fiskale ndaj shtetit rregullisht deri në këtë moment si dhe nuk ka asnjë detyrim ndaj personave fizik as juridik brenda dhe jashtë vendit.

**PRANUSI:** Shefqet Dizdari i biri i Saliut i datlindjes 1955 lindur në Tropojë, banues në Tiranë Rr. Riza Cuka, Pallati Nr.4 Shk.2 Ap.21, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar në

*Pranusi* .. , deklaroi se pranon nga dhuruesi Ndrëçim Shehaj shoqërinë "ILIRIA" '98 sh.p.k.. Pranusi merr përsipër zbatimin e marrëveshjes sipas kushteve të përcaktuara që bën fjalë për qiranë e lokalit me drejtorinë e Teatrit të Kukullave, ku aktualisht ndodhen zyrat dhe ushtron aktivitetin shoqëria. Që nga ky moment i nënshkrimit të kësaj kontrate dhuruesi Ndrëçim Shehaj çveshet nga të drejtat e ortakut të vetëm si themelues i shoqërisë si dhe e drejta e pronësis mbi të dhe të drejtat e ortakut të vetëm si dhe e drejta e pronësis e çdo e drejtë tjetër që lidhet me shoqërinë "ILIRIA" '98 sh.p.k. i kalon pranusit Shefqet Dizdari.

Kjo kontratë u përpilua me vullnetin e lirë e të plotë të palëve pa vretje dhe u nënshkrua prej tyre para meje noteres publike Miranda Xhemalçe. Unë noterja e vërtetoj sipas ligjit.

**DHURUSI**

*Ndrëçim Shehaj*

*Shefqet Dizdari*

Pos. 0484224

**PRANUSI**

*Shefqet Dizdari*

**NOTERE**

MIRANCA XHEMALÇE  
NOTERE  
TEL 282 84  
TIRANE

